



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 15.5.2018, në orën 11:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu dhe Salih Salihu.

Munguan: Srgjan Mitroviq, Liburn Aliu, Driton Çausi, Enver Hoti dhe Besa Gaxherri.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.5.2018;**
- 3. Inicimi i nismës legislative të komisionit për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit**

**Kryetari i komisionit** konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.5.2018, ia përcolli komisionit vërejtjet e Besa Gaxherrit.

**3. Inicimi i nismës legislative të komisionit për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit**

**Kryetari Daut Haradinaj** për shkak të mungesës së kryesueses së GP Besa Gaxherri për nismën ligjore, ia përcolli komisionit pajtimin e grupit punues që kjo nismë të procedohet më tutje në Qeveri, pastaj në procedurën e rregullt parlamentare. Anëtarët e komisionit nënshkruan listën për këtë nismë dhe komisioni vendosi si vijon:

## P Ë R F U N D I M

Të iniciohet nisma legislative për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit.

Pas kompletimit të së njëjtës me shkresat e tjera plotësuese që kërkohen për një projektligj, e njëjta dërgohet në procedimin e rregullt fillimisht në Qeveri për mendim pastaj në procedurë të rregullt parlamentare.

### Të ndryshme

**Kryetari i komisionit** në pikën të ndryshme ftoi komisionin që të deklarohet për çështjet si vijon:

- Pasi që procedura e aplikimit për drejtor të Agjencisë së Komplekseve Memorialë është në përfundim e sipër, **intervistimi i kandidatëve caktohet për dt. 22.5.2018, në orën 10,00,**
- **Projektligji për Kompleksin Adem Jashari** është proceduar dje nga Kryesia e Kuvendit pasi që është kthyer mendimi i kërkuar nga Qeveria, ndaj **kryetari dhe Ganimete Musliu** kërkuan që stafi të janë në gatishmëri për të proceduar atë posa të krijohen kushtet e duhura procedurale për shkak të urgjencës dhe ndjeshmërisë,
- Ish asamblisti nga Drenasi është drejtuar kryetarit të komisionit për çështjen e ndotjes së mjedisit në Drenas, pasi që në legjislacionin e kaluar ky komision ka filluar me grup punues të ndërmarr veprimet e duhura, por jo të përfunduara, ndaj ekipi përkatës kërkon një intervistim me kryetarin e komisionit i cili parashtroi këtë çështje në këtë takim. **Lutfi Zharku** dhe disa anëtarë të tjerë të komisionit potencuan se kjo çështje ka filluar në ish - komisionin e legjislacionit të kaluar, por nuk ka të bëjë me anëtarët e këtij komisionit tani, ndaj ky komision nuk ka çfarë të deklarohet ngase nuk është i njohur me rastin konkret. Prandaj **kryetari i komisionit** caktoi takimin me ekipin nga ky kanal televiziv për 22 maj 2018, në orën 9,45 në lokalet e zyrës së kryetarit të komisionit,
- **Përfaqësuesi i Stone Castle, z. Rustem Geci** ka ftuar komisionin në një ceremoni të rastit, ndaj kryetari i komisionit deri të shtunën do të njoftojë komisionin për kohën e mbajtjes dhe ftesën.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

Kryetari i komisionit,

-----  
**Daut Haradinaj**